



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E OBILIQIT
OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OF OBILIC

Drejtoria për Shërbimeve Publike dhe Emergjencë

Në mbështetje të nenit 4, 9, dhe 13, të Rregullores Komunale për Transport Rrugor në Territorin e Komunës së Obiliqit me nr.I-117 dt. 29.10.2015, Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë me dt.23.04.2026 bie këtë:

SHPALLJE PUBLIKE

Për kryerjen e transportit publik rrugore të udhëtarëve në:

1. **Relacioni: Bakshi - Obiliq –Prishtinë**
2. **Relacioni: Hade e Re -Mazgit-Obiliq-Prishtinë**
3. **Relacioni: Dardhishtë - Prishtinë**

Kriteret për operatorin transportues:

Operatori transportues duhet t'i plotësoj këto kushte për ushtrimin e veprimtarisë së transportit të udhëtarëve si vijon:

1. Të ketë biznesin e regjistruar në Agjencinë Kosovare për Regjistrimin e Bizneseve (ARBK).
2. Të jetë i Licencuar për ofrimin e shërbimeve të transportit të udhëtarëve.
3. Vërtetimin nga Zyra e Administratës Tatimore që vërteton se operatori ekonomik nuk ka borxhe ndaj Administratës Tatimore.
4. Vërtetimin nga gjykata se nuk është nën hetime ose nuk ka ndonjë ndalesë ligjor. Ju lutemi paraqisni prova origjinale.
5. Dëshminë që operatori plotëson kriteret e besueshmërisë financiare.
6. Të jepni një listë të autobusëve të regjistruar dhe të siguruar.
7. Secili operator që aplikon duhet të ceke relacionin.

- Afati për dorëzimin e aplikimeve: 23.04.2026 – 08.05.2026, deri në ora 16:00.
- Aplikacioni dorëzohet në zarf të mbyllur në zyrën pritëse në Komunën e Obiliqit.

